

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tragjedia në Greqi/ Esmë Meço u vra me thikë nga bashkëshorti, xhaxhai zbulon detajet: Fëmijët ishin në shtëpi, gjithçka ishte e planifikuar
ADRESA	https://tpz.al/tragjedia-ne-greqi-esma-meco-u-vra-me-thike-nga-bashkeshorti-xhaxhai-zbulon-detajet-femijet-ishin-ne-shtepi-gjithcka-ishte-e-planifikuar-i332357
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:47:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 12:24:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b773c00116462a068b47343caade2c9e4a95d1ad6d17bbaae270c46a2374d18c
TEKSTI	226cf67cc08a7e016dbf227a9a55496beef1d60e91d1c1353b19ed43597a9181
PAMJA	16d46c1d94b4d2d6fb2a65e4a83609588469e5bc9986850d35187ef28083e97e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50975bcaeb39cf60be1ff2aa61ea9b2eb7da63e57eeec92dfae634e331f0010d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahëso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/50975bcaeb39cf60be1ff2aa61ea9b2eb7da63e57eeec92dfae634e331f0010d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 8 SEPTEMBER 2026, 1424

Tragjedia në Greqi/ Esmë Meço u vra me thikë nga bashkëshorti, xhaxhai zbulon detajet: Fëmijët ishin në shtëpi, gjithçka ishte e planifikuar

tpz.al TPZ



Një ngjarje e rëndë ka tronditur komunitetin shqiptar në Greqi, ku Esmë Meço, një grua shqiptare, humbi jetën në rrethana tragjike më 26 gusht. Sipas hetimeve paraprake, 53-vjeçari Bujar Meço, bashkëshorti i saj, dyshohet se e sulmoi me thikë pas një konflikti mes tyre. Esmë u transportua me urgjencë në spitalin e Komotinit, por nuk mundi t'u mbijetonte plagëve të marra. Pas ngjarjes, bashkëshorti dyshohet se tentoi t'i jepte fund jetës dhe u dërgua në spital, nën mbikëqyrjen e policisë.

Ngjarja mori përmasa edhe më tragjike pasi në banesë ndodheshin dy fëmijët e çiftit, një vajzë 16-vjeçare dhe një djalë 19-vjeçar. Sipas raportimeve, vajza njoftoi autoritetet, ndërsa djali, i cili ishte në gjumë në momentin e ngjarjes, u zgjua dhe mori nënën e plagosur për ta dërguar në spital, me shpresën se do të shpëtonte.

Por, sipas të dhënave të bëra publike, kjo martesë kishte pasur probleme edhe më herët. Në një lidhje online me emisionin "Me Zemër të Hapur", ishte edhe xhaxhai i viktimës, i cili u shpreh se çifti kishte prej kohësh probleme. Në vitin 2022, Esmë kishte denoncuar bashkëshortin për kërcënime, ndërsa ai ishte arrestuar në atë kohë. Pak para ngjarjes së rëndë, gruaja kishte vendosur t'i jepte fund martesës dhe kishte planifikuar të vijonte procedurat e divorcit.

Xhaxhai i viktimës ka rrëfyer detaje mbi marrëdhënien mes çiftit dhe konfliktet që kishin shoqëruar martesën e tyre. Ai tha se Esmë i kishte treguar se, nëse fëmijët do të vinin, do t'i merrte me vete, ndërsa vajza ishte veçanërisht e rëndësishme për të.

Sipas tij, konfliktet gjatë ditëlindjes së vajzës kishin lidhje me vendimin e Esmës për t'u divorcuar nga bashkëshorti. "Bujari e keqtrajtoi", është shprehur xhaxhai i viktimës, ndërsa ka treguar edhe momentet pas sulmit. Sipas tij, djali 19-vjeçar ishte në gjumë dhe, pasi u zgjua, e mori nënën e plagosur dhe e dërgoi në spital. "Jam shumë i tronditur", ka deklaruar ai. Xhaxhai i Esmës ka ngritur gjithashtu akuza të forta mbi mënyrën se si dyshohet se është zhvilluar ngjarja. Sipas tij, vrasja ishte iniciativë e bashkëshortit, ndërsa fëmijët e çiftit dhe ditëlindja e vajzës janë përdorur në kuadër të konfliktit mes tyre.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?
Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!
Nga Mero Baze

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Ngjarja e 26 gushtit ka rikthyer në vëmendje edhe një herë problemet e dhunës në familje dhe historitë e dhimbshme të familjeve shqiptare që jetojnë e punojnë në Greqi.

[Shiko të tjera video](#)

AKTUALITET / 8 September 2026, 14:16

Në QSUT kryhet për herë të parë trombektomia mekanike, ndërhyrja që u jep më shumë shanse pacientëve me goditje në tru

AKTUALITET / 8 September 2026, 14:07

Rregullorja e GJKKO për celularët, Dhoma Kombëtare e Avokatisë vendos bojkot pa afat

AKTUALITET / 8 September 2026, 14:01

Uji me baktere helmoi 139 banorë në Fushë-Arrëz, konfirmon ISHP: Shkak, moszbatimi i praktikave higjieno-sanitare në ujësjellës

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:52

Bllokimi i pagave/ Prokuroret shqyrtojnë padinë civile, në diskutim edhe kallëzimi penal. SPAK dorëzon listpagesat me formulën e re

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:43

GJKKO me rregullore të re, Haxhia: Synon të nënshtrojë avokatin në procesin gjyqësor! Kam kërkuar takim urgjent me drejtuesin e KLGJ

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:37

Hita i pakënaqur me Policinë e Shkodrës, takim me strukturat: Duhet rezultate më të forta!

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:27

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:18

Tragjike/ Po vendosnin ndriçimin e rrugës në Tropojë, korrenti godet 4 punonjës të Bashkisë! Njëri humb jetën, tre të tjerë në spital

Krujë/ Ndezi zjarr tokën e tij për të asgjësuar mbeturina bimore, por flakët u përhapën në fshatrat përreth, arrestohet 67-vjeçari

AKTUALITET / 8 September 2026, 13:05

Vlerësimi/ 'PISA 2025', Shqipëria ngjitet në renditje, Kumbaro: Kryesojmë Ballkanin Perëndimor në matematikë dhe shkencë

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:37

Operacioni/ I kërkuar nga Interpol Tirana për vjedhje me armë, arrestohet shqiptari në Greqi

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:17

Debati për pagat e magjistratëve, Balla-opozitës: Ne nuk protestojmë si ju kundër gjykatave, respektojmë vendimet e Kushtetueses

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:11

Vlorë/ Sherr në 'beach bar' në zonën e Lungomares, konfliktohen fizikisht disa persona, ndërhyjnë policia. Një në kërkim

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:02

Aksioni/ Shkelje në menaxhimin e mbetjeve, IKMT pezullon aktivitetin e kompanisë private dhe e gjobit!

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:55

Debati te Konferenca e Kryetarëve/ Bardhi përplasjet me Peleshin, për protestën e gjykatave: Zbatoni vendimin e Kushtetueses, gjyqtarët janë pa paga

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:45

Zjarret në 5 qarqe të vendit,
nga Dajti në Tërbun! Ministria
e Mbrotjtjes: 43 vatra në 24 orë,
11 janë ende active! S'ka rrezik
për banorët

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:36

Tubim pasdite/ "Ju jeni
Kryesia e turpit", protestuesit
mblidhen para Kryesisë së
Kuvendit

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:31

Sekuestrohen kamerat/
Hajdutët vjedhin dy kasaforta,
200 milionë lekë dëm ndaj dy
biznesmenëve në Berat,
policia asnjë gjurmë për
autorët

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:22

Detaje të reja/ "Konflikti nisi
për një vështrim", dinamika e
ekzekutimit të 24-vjeçarit në
Shkodër

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:16

Kuçi mohoi dhunën nga Jozi,
Policia e shpall në kërkim për
moskallëzim krimi, çfarë
deklaroi 26-vjeçari në
komisariat

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:11

Alibeaj: Berisha nuk është
lider i të gjithë opozitës. Me
vizitën në SHBA fitoi vetëm
bastin e tij personal! Drejton
një parti të gjymtuar

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

NJOFTIME NGA TPZ.AL 🔔

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja
jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në
shërbim të interesit publik.



AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE

SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE

Built & Monetized by Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.